



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY  
Adresa Rr. Zija Shemsiu pn, 60000 Gjiilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjilan.net

Rektori: Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Vendim.nr 011169/21/09/2020

Në bazë të nenit 48, pika 1.3 të Statutit të përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka" Gjiilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 10.09.2020, mori:

### VENDIM

Dr.sc. Fatmire Krasniqi, zgjedhet në thirrjen akademike **Profesor Asistent** për lëndët: Taktika kriminale, Kriminologji me Penologji, Etika ligjore dhe profesionale, Shkathtësitë praktike gjyqësore, E drejta penale ndërkombëtare dhe Krimet kibernetike në Fakultetin Juridik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjiilan. Emërimi është bërë në pajtim me kushtet e parapara në nenin 153 dhe 157 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan dhe Rregulloren për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UKZ.

I përmenduri është i obliguar që t'u përmbahet dispozitave të Statuti të Përkohshëm të Universitetit. Emërimi zgjatë 4/katër/vite.

Të përmendurit i takon paga në pajtim me Rregulloren për të ardhurat personale.

Kontrata e punës do të lidhet në pajtim me dispozitat pozitive.

### Arsyetim

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan ka shpallur konkurs për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: Taktika kriminale, Kriminologji me Penologji, Etika ligjore dhe profesionale, Shkathtësitë praktike gjyqësore, E drejta penale ndërkombëtare dhe Krimet kibernetike, në Fakultetin Juridik në Universitetin Publik "Kadri Zeka" Gjiilan.

Komisioni recensues dhe Komisioni i studimeve i ka propozuar Senatit të Universitetit që Dr.sc. Fatmire Krasniqi, i plotëson kushtet për t'u zgjedhur në thirrjen akademike Profesor Asistent për lëndët e sipërpërmendura.

Senati i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, duke i marrë për bazë vlerësimin e Komisionit Recensues dhe propozimin e Komisionit të Studimeve, vendosi që Dr.sc. Fatmire Krasniqi, të zgjedhet në thirrjen akademike Profesor Asistent.

Në bazë të kësaj që u tha më sipër u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në web faqe të Universitetit drejtuar Komisionit për Ankesa dhe Parashtrës të Senatit të Universitetit.

REKTORI  
Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Vendimi t'i dërgohet:

1. Të përmendurit
2. Zyrës së personelit
3. Arkivit të Universitetit
4. Zyrës së financave